



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	05.02.2026
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – DHJETOR 2025

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2025, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.12.2025-31.12.2025

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kërkesave të bartura. Gjatë muajit dhjetor 2025-janë pranuar gjithsejtë 72¹-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura nga muaji paraprak kanë qenë 14 lëndë, në total 86 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 49 kërkesa, 34 të miratuara, 14 të refuzuara dhe 1 e bartur në kompetencë. Për shqyrtim në muajin vijues (janar 2026) barten 37 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në muajin dhjetor janë pranuar dukshëm më shumë kërkesa krahasuar me muajin paraprak të këtij viti. Për nga struktura, kërkesat në numër më të madh janë ato për legalizim – 26 dhe për kushte ndërtimi -9.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesen e taksave sipas kategorive të caktuara. Lidhur me këte janë lëshuar 13 konkluzione për pagesen e taksave. Prej tyre 3 konkluzione për leje ndërtimi, 5 për leje mjedisore komunale, 3 për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimi dhe 2 për certifikatë legalizimi.

Po, ashtu DPUMM ka përgatitur dhe adresuar te palët ftesa për plotësimin e dokumentacionit. Në kuadër të kësaj është lëshuar 1 ftesë për kompletim të lëndës. Brenda muajit dhjetor pjesërisht është pranuar dokumentacioni përkatës për plotësimin e lëndëve. Janë pranuar 2 raporte nga inspektorët e ndërtimit të cilat janë të ndërlidhura me aplikimet për certifikatë përdorimi. Gjatë muajit dhjetor janë pranuar edhe 8 kërkesa lidhur me ndryshimin/plotësimin e HZK².

Aktivitetet të tjera janë kryer edhe si:

Është hartuar dhe dorëzuar me kohë Raporti për Agjenden Evropiane për vitin 2025.

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare, proces që zbatohet nga AKK. Procesi mbikëqyret dhe mbështetet nga DPUMM.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

Përpunimi i të dhënave për hartimin e Planit të punës për vitin 2026; dhe
Përpunimi i të dhënave për hartimin e Raportit të punës për vitin 2025.

Aktivitetet tjera themelore për shqyrtim në vitin 2026:

- *Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të bartura;*
- *Aktivitetet lidhur me PZHK-në;*
- *Aktivitetet lidhur me propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e HZK:*

¹ Janë pranuar edhe 3 kërkesa të tjera për plotësim dokumentacioni bazuar në kërkesat e parashtruara paraprakisht.

² Këto kërkesa duhet të trajtohen në procesin e ndryshim/plotësimit të HZK-së.

- Aktivitetet lidhur me PLVM;
- Emërtimi i rrugëve.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Tabela 1.

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Pushim procedure -pezullim	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	9	2	5 ³		4		2 ⁴
2.	Leje ndërtimi	4	4	4				4 ⁵
3.	Leje rrënimi	1						1
4.	Certifikatë Përdorimi	2						2
5.	Akte nga MMPHI- rish.							
6.	QRTK-bartje në kompetencë	1 ⁶		1				
7.	Informacione urbane	3	1	4				
8.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	26	3	4		3		22
9.	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
10.	Bashkim/ndarje e parcelave		2	1				1
11.	Kërkesë për LMK	4	2	4		1		1
12.	Qasje në dokumente	1		1				
13.	KN për park solar	3 ⁷						3
14.	Ankesë – legalizim	4				4		
15.	Qasje në rrugë							
16.	Pëlqim për rrjet energj.	2				2		
17.	Panele në objekt	1						1
18.	Tërheqje lënde	8		8				
19.	Kopje të C. së legalizim.	1		1				
20.	Detyrë projektuese	2		1			1	
21.	Kërkesë tjetër							
	Gjithsejtë:	72	14	34		14	1	37

Shënim:

Nga 72 kërkesa të pranuar në muajin dhjetor, vetëm nga data 26 dhjetor e deri me 31 dhjetor 2025 janë pranuar 37 kërkesa të natyrave të ndryshme. Ky numër i kërkesave të pranuar ditëve të fundit të muajit dhjetor ka ndikuar në numrin e lëndëve të bartura në muajin vijues. Meqenëse me 31.12.2025 përfundon afati

³ Një kërkesë për KN e pezulluar është shqyrtuar dhe miratur

⁴ Për një lëndë për Kushte ndërtimi është shtyer afati i shqyrtimit për shkak të zgjidhjes së një çështjeje paraprake.

⁵ Për një lëndë për Leje ndërtimi është shtyer afati i shqyrtimit për shkak të çështjeve pronësore. Pritet sqarimi nga DGJK dhe SPJ.

⁶ Vazhdim i kushteve ndërtimore pas qartësimit lidhur me kompetencën lëndore për trajtimin e kërkesave për ndërtim në zonat e veçanta të mbrojtura.

⁷ Në fakt këto kërkesa janë për Kushte ndërtimi, mirëpo duke pasur parasysh se kanë të bëjnë me ndërtimin e parqeve solare i kemi sistemuar në grup të veçantë.

i aplikimit për legalizim të objekteve, është parashtruar një numër i konsideruesëm i kërkesave të kësaj natyre (26 të tilla).

Ndikim në shqyrtimin e kërkesave kishte edhe fakti se në periudhën nga data 22 deri me 31.12.2025 tre punonjës kanë qenë në pushim vjetor.

Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi

Tabela 2.

Nr.	Kategoria e ndërtimit	Sipërf. Tokës – m2	Sip.ndëtesës- m2	Destinimi	Vendi
1.	II	2085	6056.73 B 1244 A	NLB	Lipjan
2.	II	1496	1264.78 B 273.31 A	NLB	Lipjan
3.	I	1000	500	Afarist	Lipjan
4.	I	5066	1141	Afarist	Banullë
Gjithsejtë		7192	8727.91		

Tokë e shfrytëzuar vetëm për afarizëm = 6066 m2 me gjithsejtë ndërtim për afarizëm prej 1641 m2, kurse tokë e shfrytëzuar për banim dhe afarizëm në qytet 3581 m2 në të cilën janë ndërtuar 7321.51 m2 për banim dhe 1517.31m2 për afarizëm (NLB). Proporcioni i ndërtimit me destinim për banim është 87% kurse për afarizëm vetëm 13%.

Në bazë të analizës së sipërfaqeve për ndërtim sipas destinimit del se gjatë muajit dhjetor 2025 – rreth 41% e hapësirave të tokës ku është ndërtuar, ndërtesat janë destinuar për banim, kurse rreth 59% e tyre janë destinuar për afarizëm. Ndërsa, proporcioni i ndërtimit me destinim për banim dhe afarizëm (NLB) është rreth 77% për banim kurse për afarizëm rreth 23%. Në përqindjen e afarizmit ka ndikim të theksuar pjesa afariste në kuadër të ndërtesës së lartë për banim dhe afarizëm, ku 1517.31 m2 janë afariste dhe pjesa tjetër prej 7321.51m2 janë për banim⁸.

Këto fakte flasin në vazhdimësi se investimet direkte në fushën e ndërtimeve për qëllime të zhvillimit ekonomik janë tejet të vogla krahasuar me ato për qëllime banimi.

Buxheti:

Gjatë muajit dhjetor 2025 të hyrat nga kategoritë e ndryshme nga fusha urbane janë relativisht të ulëta krahasuar me muajin paraprak.

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:.....41,344.86€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej:10,097.00€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej.....4,318.53€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:.....421.90€
- Të hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej00€

Shuma totale e të hyrave:56,182.53€

Të dhënat lidhur me të hyrat për muajin dhjetor 2025 janë pranuar nga sektori i financave në kuadër të Drejtoratit përkatës të Komunës së Lipjanit.

⁸ Sipas të dhënave nga ASK nga regjistrimi i popullsisë dhe pasurisë të zhvilluar gjatë vitit 2024, në Komunën e Lipjanit 35.3% e njësive banesore (shtëpi dhe banesa) janë të pa shfrytëzueshme.

Lidhur me shpenzimet kemi kryer obligimet ndaj operatorëve ekonomik. Nga kategoria ekonomike “Mallra dhe shërbime” mjetet e pashtpenzuara janë simbolike. Megjithate për shumën e zotuar për nevoja të Drejtoratit të Administratës, nuk kemi arritur të marrim të dhëna për nivelin e shpenzimeve.

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit dhjetor 2025 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.